

V E N D I M
Nr.882, datë 16.12.1996

**PËR DISA KRITERE PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR NDËRTIMIN
DHE BLERJEN E BANESAVE**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore kanë të drejtë të përdorin fitimet e tyre për ndërtimin e banesave ose blerjen e truallit dhe të banesave nga tregu i lirë vetëm për punonjësit e tyre, duke zbatuar kriteret e mëposhtme:

a) Miratimi i fondeve bëhet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

b) Ndërtimi i banesave të bëhet sipas normativave shtetërore të projektimit të banesave dhe të kostos mesatare vjetore të Entit Kombëtar të Banësive, duke përjashtuar vleftën e truallit.

c) Blerja e truallit mund të bëhet nga tregu i lirë, sipas vleftave të tregut.

ç) Blerja e banesave nga tregu i lirë mund të bëhet pa përjashtim në çdo rreth të vendit, por me kusht që fondet shtetërore të përdoren për çmime të tregut deri në maksimum të barabartë me koston mesatare vjetore të Entit Kombëtar të Banësive dhe për banesa brenda normativave shtetërore të projektimit të tyre. Diferencat në çmimin e blerjes të paguhet në mënyrë të menjëhershme nga punonjësit që përfitojnë strehim.

d) Të gjitha procedurat e prokurimit të fondeve për ndërtim dhe blerjen e banesave e të truallit nga tregu i lirë lejohet të bëhen nga vetë ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

dh) Mënyra e shlyerjes së detyrimeve financiare të punonjësve që përfitojnë banesë, do të bëhet sipas dispozitave ligjore që Enti Kombëtar i Banësive përdor për shitjen e banesave të financuara prej tij.

Të gjitha detyrimet financiare do të derdhen në një llogari të veçantë të Bankës së Kursimeve në favor të Ministrisë së Financave, për t'u përdorur nga Banka e Kursimeve për mbulimin e subvencioneve shtetërore për familjet e pastrehë, në bazë të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastrehë" dhe akteve nënligjore të tij.

e) Banesat ndahen nga vetë ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore, kurse autorizimet do të merren pranë bashkive dhe komunave, duke trajtuar me përparësi punonjësit që kanë statusin e pastrehë, sipas dispozitave në fuqi.

2. Në të gjitha rastet e përdorimit të fondeve shtetërore për ndërtim ose blerje banese, sipërfaqet e tepërta mbi normativat shtetërore të projektimit të banesave do të paguhet në mënyrë të menjëhershme nga punonjësit dhe qytetarët që i kanë përfituar ato.

3. Për banesat që do të ndërtohen, ose janë në proces ndërtimi, çdo subjekt investitor që përdor fonde shtetërore për banesë, duke përfshirë edhe Entin Kombëtar të Banësive, është i detyruar që, brenda një muaji pas marrjes në dorëzim të banesës, të lidhë kontratat e shitblerjes së banesës në degët e Bankës së Kursimeve, sipas dispozitave ligjore të pikës 1, shkronja "dh" të këtij vendimi.

I njëjti kriter do të zbatohet edhe për rastet e blerjes së banesave nga tregu i lirë.

4. Për banesat e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga subjektet investitore, afati për lidhjen e kontratave të shitblerjes është 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Në rast se kriteret e pikave 2, 3, 4 shkelen mbi 6 muaj, atëherë banesat kalojnë në pronësi të bashkive dhe komunave, për t'u përdorur prej tyre si banesa me qira, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim.

Qytetarët që banojnë në këto banesa, janë të detyruar t'u nënshtrohen kriterëve për pagesën e qirasë që nga koha e marrjes në dorëzim të këtyre banesave.

Ngarkohen pushtetet lokale për zbatimin e kësaj pike.

6. Në të gjitha rastet kur qytetarët kanë përfituar ose do të përfitojnë zgjerim banese, janë të detyruar të dorëzojnë më parë banesën që kanë përfituar nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ose një banesë tjetër ekuivalente në sipërfaqe dhe në vleftë me atë.

Në të kundërt atyre u humbet e drejta e përfitimit të zgjerimit të banesës.

7. Vendimi nr.527, datë 17.10.1994 “Për shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.577, datë 6.12.1993 “Për ndërtimin, shpërndarjen dhe administrimin e banesave që ndërtohen nga ndërmarrjet shtetërore me fitimet e tyre””, si dhe të gjitha aktet e t